



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

BURSA PËR STUDIME UNIVERSITARE DHE PASUNIVERSITARE NË TURQI

VITI AKADEMIK 2020-2021

Në kuadër të programit ndërkombëtar të bursave, Presidenca e Turqve Jashtë Vendit dhe Komuniteteve të Lidhura (*Presidency for Turks Abroad and Related Communities*) ofron bursa studimi universitare/ pasuniversitare ose në fushën e kërkimit për shtetasit e huaj, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet në universitetet turke për vitin akademik 2020-2021.

Kriteret bazë për aplikimin që duhet të plotësojnë kandidatët:

- Të jenë shtetas të huaj;
- Të jenë nën moshën 21 vjeç për programet universitare;
- Të jenë nën moshën 30 vjeç për programet e Masterit;
- Të jenë nën moshën 35 vjeç për programet e Doktoratës;
- Të plotësojnë kriteret akademike të përcaktuara nga universitetet;
- Të jenë të diplomuar ose në fund të vitit aktual akademik (para shtatorit 2020).

Për programet e studimit që do të zhvillohen në gjuhën turke, kandidatët do t'i nënshtrohen vitit përgatitor të gjuhës turke. Në disa universitete, programe të veçanta studimi mund të ndiqen edhe në gjuhën angleze ose frënge. Kusht për fillimin e studimeve në këto gjuhë është dhënia e provimit ndërkombëtar dhe certifikimi për njohjen e gjuhës së huaj (SAT, TOEFL, DELF, YDS).

Procedura e aplikimit përfshin:

- a) Plotësimin e formularit të aplikimit, i cili gjendet në adresën e internetit: <http://www.turkiyeburslari.gov.tr>. Kandidatët, do të bëjnë fillimisht regjistrimin online. Pasi të kenë hyrë në sistem, kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit duke përcaktuar fushën e studimit;
- b) Kandidatët e interesuar për studime universitare, gjithashtu, duhet të shkarkojnë në sistemin online dokumentet e skanuara në formatin PDF sipas listës në vijim:
 - Diplomën dhe listën e notave të firmosur nga Drejtoria ose Zyra Arsimore e rrethit përkatës, i cili duhet të legalizohet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore, Tiranë;
 - Fotokopjen e faqes së pasaportës ku jepen të dhënat e identitetit;

Dokumentet e mësipërme duhet të përkthehen në gjuhët turke/angleze/ ose frënge, të noterizohen dhe të legalizohen, sipas kriterëve të përcaktuara nga universitetet përkatëse turke.

Procedurat e seleksionimit për fituesit e bursave realizohen nga universitetet turke. Bursa e studimit mbulon të gjitha shpenzimet e ushqimit, të akomodimit, si dhe tarifën e shkollimit. Studenteve të përzgjedhur do t'iu jepet edhe një bursë mujore në varësi të programit akademik të përzgjedhur.

Lidhur me afatet e aplikimit, kandidatët do t'i referohen kalendarit të aplikimeve në faqen e publikimeve në web për bursat e ofruara në programe për studime universitare ose pasuniversitare.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, si dhe të listës së universiteteve përkatëse, referojuni adresave të mëposhtme në web-site:

<http://www.turkiyeburslari.gov.tr>;

<https://turkiyeburslari.gov.tr/en/page/prospective-students/how-to-apply>;

<https://turkiyeburslari.gov.tr/en/page/prospective-students/application-criteria>;

<https://turkiyeburslari.gov.tr/Content/20019-calendar.pdf>;

e-mail: info@turkiyeburslari.org.

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE
ASISTENCËS**